

VENDIM
Nr. 589, datë 17.7.2013

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 545, DATË 11.8.2011 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË
NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE, ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË
KABINETEVE, NË KRYEMINISTRI, APARATET E MINISTRIVE TË LINJËS,
ADMINISTRATËN E PRESIDENTIT, KUVENDIT, KOMISIONIT QENDROR TË
ZGJEDHJEVE, PROKURORINË E PËRGJITHSHME, GJYKATËN E LARTË, DISA
INSTITUCIONE TË PAVARURA, INSTITUCIONET NË VARËSI TË KRYEMINISTRIT,
INSTITUCIONET NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS DHE ADMINISTRATËN E
PREFEKTIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 18 e 29 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 4/2 të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, dhe të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 545, datë 11.8.2011 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

- a) Në fund të pikës 1/2 shtohet emërtesa “**Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor**”.
- b) Në pikën 1/3/a, emërtesat “Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme” dhe “Instituti Gjeografik i Ushtrisë”, shfuqizohen.
- c) Në pikën 1/3/b shtohet emërtesa “**Instituti Gjeografik i Ushtrisë**”.
- ç) **Lidhja nr. 1**, që përmendet në pikën 2, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
- d) Shkronja “b” e pikës 2, riformulohet si më poshtë vijon:
“b) Shtesa për vjetërsi në punë (kolona 3) e lidhjes nr. 1, jepet në masën 2% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi pagën e grupit. Për efekt të llogaritjes së kësaj shtese, vite pune do të konsiderohen vjetërsia e përgjithshme në punë, e dokumentuar në librezën e punës së çdo punonjësi, me përjashtim të viteve të sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, shërbimit ushtarak për meshkujt, vitet e shkollimit në institucionet e arsimit të lartë dhe periudha e trajtimit me pagesë papunësie.”.
- dh) Në fund të pikës 4/1 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:
“Zbatimi i kësaj shtese, i miratuar për nëpunësit aktualë deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, të vazhdojë deri në fund të vitit 2013.”.
- e) Paragrafi i parë i pikës 5 riformulohet si më poshtë vijon:
“-“Specialist arkivi”, në Kryeministri, Presidencë, Kuvend, aparatet e ministrive të linjës, si dhe në pozicionet “përgjegjës sektori” dhe “specialist” në drejtoritë apo sektorët e përmbajtjes në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave dhe drejtoritë rajonale/vendore të sistemit të arkivave të shtetit;”.
- ë) Pika 6 riformulohet si më poshtë vijon:

“6. Struktura dhe nivelet e pagave për zëvendësministrin, prefektin, nënprefektin, nëpunësit e kabineteve në Kryeministri, institucione të pavarura, aparatet e ministrive të linjës dhe prefekturë janë si vijon:

- Zëvendësministër 140000 lekë;
- Drejtor i kabinetit të Presidentit, të Kryeministrit, të Kryetarit të Kuvendit, të Prokurorit të

Përgjithshëm, të kryetarit të Gjykatës së Lartë dhe të kryetarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, barazohet në pagë me nëpunësin civil të kategorisë I-a.

- Këshilltari i Presidentit, i Kryeministrit, i Kryetarit të Kuvendit, i kryetarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, këshilltari për protokollin i Kryeministrit, këshilltari për protokollin i Presidentit, zëdhënësi i Presidentit, drejtori i kabinetit të Zëvendëskryeministrit, drejtori i kabinetit të Avokatit të Popullit, Koordinatori Kombëtar për Urdhrat Profesionalë, pranë Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit barazohen në pagë me Zëvendësministrin;

- Këshilltari i Prokurorit të Përgjithshëm, i kryetarit të Gjykatës së Lartë, i Avokatit të Popullit, ndihmësi i Presidentit, i Kryeministrit dhe i Kryetarit të Kuvendit dhe këshilltari i Zëvendëskryeministrit barazohen në pagë me nëpunësin civil të kategorisë I-b.

- Ndihmësi i Zëvendëskryeministrit dhe i nënkryetarit të Kuvendit, drejtori i kabinetit të ministrit dhe drejtorët e kabineteve të titullarëve të institucioneve të tjera të pavarura, të përmendura në pikën 1/1 më sipër, barazohen në pagë me nëpunësin civil të kategorisë II-a.

- Këshilltari i ministrit, zëdhënësi i ministrit dhe këshilltarët dhe zëdhënësi i titullarëve të institucioneve të tjera të pavarura, të përmendura në pikën 1/1 më sipër, barazohen në pagë me nëpunësin civil të kategorisë II-b.

- Ndihmësit ligjorë pranë prokurorëve në Prokurorinë e Përgjithshme dhe ekspertët në Prokurorinë e Përgjithshme barazohen në pagë me nëpunësin civil të kategorisë III-a.

- Prefekti i Qarkut të Tiranës 118500 lekë.

- Prefekti i qarqeve të tjera 110500 lekë.

- Nënprefekti i nënprefekturave Kavajë, Lushnjë dhe Sarandë 95000 lekë.

- Nënprefekti i nënprefekturave Krujë, Pogradec, Librazhd, Tepelenë, Përmet, Mat, Pukë, Tropojë dhe Skrapar 88000 lekë.

- Nënprefekti i nënprefekturave Malësi e Madhe, Bulqizë, Peqin, Gramsh, Devoll, Mallakastër, Has, Kuçovë, Mirditë, Delvinë, Kurbin dhe Kolonjë 83800 lekë.

- Këshilltari i Prefektit të Qarkut të Tiranës 66500 lekë.

- Zëdhënësi i Prefektit të Qarkut të Tiranës 56500 lekë.

- Sekretari i Presidentit, i Kryeministrit, i Kryetarit të Kuvendit, i Kryetarit të Gjykatës së Lartë, i Prokurorit të Përgjithshëm, i Zëvendëskryeministrit, i nënkryetarit të Kuvendit dhe i Avokatit të Popullit 70000 lekë.

- Sekretari i ministrit, sekretar në zyrën e Avokatit të Popullit, sekretar i titullarëve të institucioneve të tjera të pavarura, të përmendura në pikën 1/1 më sipër, sekretari i organit kolegjal drejtues, sekretar në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës dhe institucionet e pavarura, të përmendura në pikën 1/1 të këtij vendimi 59000 lekë.

Shtesa për vjetërsi në punë për të gjitha pozicionet sekretar jepet në masën 2% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet dhe llogaritet mbi vlerën 14 000 (katërmëdhjetë mijë) lekë në muaj. Për efekt të llogaritjes së kësaj shtese, vite pune do të konsiderohen vjetërsia e përgjithshme në punë, e dokumentuar në librezën e punës së çdo punonjësi, me përjashtim të viteve të sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, shërbimit ushtarak për meshkujt, vitet e shkollimit në institucionet e arsimit të lartë për femrat dhe periudha e trajtimit me pagesë papunësie.

Të drejtën për të pasur këshilltarë të jashtëm e ka vetëm Kryeministri. Pagesa e tyre mujore është deri në 40% të pagës mujore të këshilltarit të brendshëm. Masa e pagesës përcaktohet nga titullari i

institucionit përkatës.

f) Lidhja nr. 5/2, që përmendet në pikën 9, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

g) Lidhja nr. 6, që përmendet në pikën 10, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

gj) Pika 10/1 shfuqizohet.

h) Lidhja nr. 6/8, që përmendet në pikën 10/8, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

i) Lidhja nr. 6/9, që përmendet në pikën 10/9, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

j) Lidhja nr. 7/1 (pjesa I dhe II), që përmendet në pikën 11/1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

k) Lidhja nr. 7/4, që përmendet në pikën 11/4, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

l) Lidhja nr. 8, që përmendet në pikën 12, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

ll) Pika 13/1 shfuqizohet.

m) Lidhja nr. 9/4, që përmendet në pikën 13/4, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare të këtij vendimi për vitin 2013:

- Për Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor të fillojnë nga data e emërimit të nëpunësve në detyrë. Vlerat e klasave/kategorive të pagave për nëpunësit e këtij institucioni për periudhën përpara datës 15 korrik 2013 të jenë sipas vendimit nr. 524, datë 16.8.2012 të Këshillit të Ministrave.

- Për të gjitha parashikimet e tjera të fillojnë nga data 15 korrik 2013.

3. Efektet financiare të këtij vendimi për vitin 2013:

- Për Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor për periudhën nga data e emërimit të nëpunësve në detyrë deri në datën 15 korrik 2013, të përballohen nga fondet e parashikuara për këtë institucion për vitin 2013.

- Për të gjitha parashikimet e tjera të përballohen nga fondet e parashikuara për politikën e rritjes së pagave për vitin 2013.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr. 1

STRUKTURA E PAGAVE PËR NËPUNËSIT CIVILË/NËPUNËSIT NË TË GJITHA INSTITUCIONET
PJESË E FUSHËS SË VEPRIMIT TË KËTJ VENDIMI

Klasa	Kategoritë	PAGA MUJORE			
		Paga individuale (paga bazë)			Shtesa e pozicionit
	1	2	3	4	5
		Paga e grupit (PG) lekë	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV) në përqindje	Shtesa për kualifikim (SHK) lekë	Shtesa për pozicion (SHP) lekë
I	I-a		2%		129.000

	I-b		2%		118.000
II	II-a		2%		107.800
	II-b		2%		91.700
III	III-a		2%	0	74.400
	III-a/1		2%	0	65.200
	III-b		2%	0	57.000
IV	IV-a		2%	0	45.800
	IV-b		2%	0	35.500
	IV-c		2%	0	27.500

Lidhja nr. 5/2

**NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT KËRKIMORË E SHKENCORË
NË AKADEMINË E SHKENCAVE**

	Emërtimi	Paga në lekë
1.	Kryetar i Akademisë së Shkencave	174.760
2.	Zëvendëskryetar i Akademisë së Shkencave Sekretar Shkencor i Akademisë së Shkencave	140.000
3.	Akademik	125.000
4.	Akademik i Asociuar Profesor	110.000
5.	Profesor i Asociuar	96.000

**SHTESAT NË PËRQINDJE MBI PAGËN MUJORE PËR FUNKSIONE DREJTUESE
TË PUNONJËSVE SI MË SIPËR**

Pozicioni	Shtesa në lekë
Kryetar seksioni. Sekretar shkencor i seksionit	12000

Lidhja nr. 6

**KATEGORITË E PAGAVE TË POZICIONEVE TË PUNËS SË NËPUNËSVE PËR EMËRTESAT
“SPECIALIST” DERI NË “TITULLAR INSTITUCIONI” NË INSTITUCIONET QENDRORE
TË PËRCAKTUARA SIPAS PIKËS 1/3/A TË KËTIJ VENDIMI**

Pozicioni	Kategoria	Kriteri minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt të pranimit në pozicionin përkatës të punës Paga e grupit
Titullar i institucionit	II-a	1
Zv/titullar i institucionit; Inspektor në Agjencinë e Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Europian; Drejtor drejtorie në Agjencinë Kombëtare të Provimeve;	II-b	1

Drejtor në drejtoritë e përmbajtjes në Shkollën Shqiptare të Administratës Publike		
Drejtor drejtorie; Anëtar i Komitetit Shtetëror të Kulteve; Kapiteni i porteve	III-a	1
Përgjegjës sektori; Kapiteni i Portit	III-a/1	1
Përgjegjës sektori; Menaxher trajnimi në Shkollën Shqiptare të Administratës Publike	III-b	1
Inspektor; Ekspert në Drejtorinë e Policisë Shkencore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit	III-b	1 ose 2
Specialist	IV-a	1 ose 2 ose 3
	IV-b	1 ose 2 ose 3

Lidhja nr. 6/8

KATEGORITË E PAGAVE DHE SHITESAT PËR KUSHTE PUNE TË PUNONJËSVE
TË SISTEMIT DOGANOR

	POZICIONI			SHITESA E POZICIONIT	
Klasifikimi doganor		Kategoria	Kriteri minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt të pranimit në pozicionin përkatës të punës Paga e grupit	Shtesa e pozicionit (SHP)	Shtesa për kushte pune
	Titullar i institucionit	II-a	1		20000
	Zv/drejtor i përgjithshëm	II-b	1		15000

A	Këshilltar. Drejtor drejtorie. Drejtor drejtorie rajonale. Kryetar i degës doganore Tiranë, Durrës, Vlorë, Shkodër, Kakavijë, Rinas	III-a	1		15000
B	Përgjegjës/shef sektori. Kryetar dege doganore Fier, Kapshticë, Korçë, Lezhë, Bllatë, Kukës, Sarandë, Berat, Tri Urat, Qafë Thanë, Elbasan. Përgjegjës operacionesh doganore në degën doganore Tiranë, Durrës	III-a/1	1		14000
C1	Inspektor kontrolli i brendshëm. Përgjegjës turni. Përgjegjës zyre. Komandant grupi antikontrabande. Specialist. Administrator rrjeti	III-b	1 ose 2		14000
	Financier në degë doganore , përkthyes, koordinator në DOH, specialist i marrëdhënieve ndërkombëtare	III-b	1 ose 2		10000
C2	Doganier kontrolli dokumentar, fizik. Inspektor antikontrabande. Asistent laborator. Llogaritar	IV-a	1 ose 2 ose 3		10000
C3	Doganier pranues. Doganier peshoreje. Doganier pike kontrolli. Përpunues informacioni. Sekretar. Arkivist			37000	5000
D1	Magaznier. Furnitor. Operator. Shofer. Teknik			32000	1500
D2	Punëtor mirëmbajtës			Klasa IV (sipas vendimit të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve mbështetës)	
D3	Punonjës pastrimi			Klasa I (sipas vendimit të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve mbështetës)	

Lidhja nr. 6/9

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E SISTEMIT TË TATIMEVE

				PAGA MUJORE	
			EMËRTIMI	PAGA INDIVIDUALE	SHTESA E POZICIONIT

Kategoria e vendit të punës	Kategoria e pagës	Paga e grupit (PG)		Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)	Shtesa për kushte pune
1	2	3	4	5	6	7	8
	II-a	1	Drejtor i përgjithshëm	2%			20000
	II-b	1	Zv/drejtor i përgjithshëm	2%			15000
A	III-a	1	Drejtor drejtorie në drejtorinë e përgjithshme. Drejtor i drejtorisë rajonale	2%	0		15000
B	III-a/1	1	Përgjegjës/shef sektori në drejtorinë e përgjithshme. Drejtor drejtorie në drejtoritë rajonale	2%	0		14000
C.1	III-b	1 ose 2	Përgjegjës/shef sektori/ zyre në drejtoritë rajonale. Inspektor i parë. Inspektor i auditit të brendshëm. Përgjegjës sektori në drejtoritë mbështetëse në drejtorinë e përgjithshme. Inspektor hetimi në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve	2%	0		12000
	III-b	1 ose 2	Përgjegjës zyre në Task Forcë	2%	0		17000
C.2	IV-a	1 ose 2 ose 3	Inspektor i dytë. Specialist në drejtorinë e përgjithshme. Inspektor hetimi në drejtorinë e përgjithshme dhe në drejtoritë rajonale	2%	0		12000
	IV-b	1 ose 2 ose 3	Specialist në drejtorinë e përgjithshme. Inspektor hetimi/ specialist në drejtoritë rajonale	2%	0		10000
C.3	IV-c	1 ose 2 ose 3	Specialist	2%	0		5000
D.1	IV-b	1 ose 2 ose 3	Sekretar në drejtorinë e përgjithshme	2%	0		5000
	IV-c	1 ose 2 ose 3	Sekretar në drejtoritë rajonale	2%	0		5000

Lidhja nr. 7/1

**NIVELET E PAGAVE TË PUNONJËSVE TË TRUPËS ARTISTIKE NË TEATRIN KOMBËTAR,
TEATRIN KOMBËTAR TË OPERËS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR, NË DREJTORINË E
TEATRIT TË FËMIJËVE NË QENDRËN KOMBËTARE TË KULTURËS PËR FËMIJË DHE TEATRIN
KOMBËTAR TË KOMEDISË**

I. Për Teatrin Kombëtar dhe Drejtorinë Artistike të Teatrit të Operës dhe Baletit në Teatrin Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor

Nr.	Pozicioni	Paga
1	Dirigjent Regjisor Solist i parë Koncertmaestër Baletmaestër Aktor i parë Solist II (spala sektori)	79.200 lekë
2	Asistent dirigjent Asistent regjisor Aktor i dytë Orkestrat i kategorisë së parë	71.000 lekë
3	Korist i kategorisë së parë Balerin i kategorisë së parë Skenograf i kategorisë së parë	59.800 lekë
4	Aktor i tretë	58.300 lekë
5	Orkestrat i kategorisë së dytë Korist i kategorisë së dytë Balerin i kategorisë së dytë Skenograf i kategorisë së dytë	49.500 lekë

II. Për Drejtorinë Artistike të Ansamblit të Këngëve dhe Valleve Popullore në Teatrin Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor, Drejtorinë e Teatrit të Fëmijëve në Qendrën Kombëtare të Kulturës për Fëmijë, Teatrin Kombëtar të Komedisë dhe Çirkun Kombëtar

Nr.	Pozicioni	Paga
1	Dirigjent Regjisor Drejtues artistik	71.000 lekë
2	Solist i parë Orkestrat i kategorisë së parë Aktor i parë Skenograf i kategorisë së parë Korist i kategorisë së parë Valltar i kategorisë së parë Akrobat i kategorisë së parë Mjeshtër i studios së cirkut Mjeshtër profili i numrave të cirkut	59.800 lekë
3	Solist i dytë Orkestrat i kategorisë së dytë Aktor i dytë Skenograf i kategorisë së dytë Korist i kategorisë së dytë Valltar i kategorisë së dytë	49.500 lekë

	Akrobat i kategorisë së dytë	
--	------------------------------	--

Lidhja nr. 7/4

**NIVELET E PAGAVE TË PUNONJËSVE TË TRUPËS ARTISTIKE NË QENDRËN E KULTURËS,
MEDIAS DHE BOTIMEVE TË MBROJTJES**

Nr.	Pozicioni	Paga
1	Udhëhegës artistik	79.200 lekë
2	Dirigjent Regjisor	71.000 lekë
3	Instrumentist Vokalist	59.800 lekë

Lidhja nr. 8

**KATEGORITË E PAGAVE TË POZICIONEVE TË PUNËS SË NËPUNËSVE PËR EMËRTERESAT
“SPECIALIST” DERI NË “TITULLAR INSTITUCIONI” NË INSTITUCIONET QEDNRORE TË
PËRCAKTUARA SIPAS PIKËS 1/3/C TË KËTIJ VENDIMI**

Pozicioni	Kategoria	Kriteri minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt të pranimit në pozicionin përkatës të punës Paga e grupit
Titullar i institucionit	III-a	1
Drejtor drejtorie Sekretar i përgjithshëm në federatat sportive	III-b	1
Përgjegjës sektori	IV-a	1
Inspektor	IV-a	1 ose 2
Specialist	IV-b	1 ose 2 ose 3
Restaurator Lektor Arkivist/katalogist Historian	IV-c	1 ose 2 ose 3

Lidhja nr. 9/4

**KATEGORITË E PAGAVE DHE SHITESAT PËR KUSHTE PUNE TË POZICIONEVE TË PUNËS SË
NËPUNËSVE PËR EMËRTERESAT “SPECIALIST” DERI NË “TITULLAR INSTITUCIONI” NË
DREJTORITË E AGJENCISË SË LEGALIZIMIT, URBANIZIMIT DHE INTEGRIMIT TË
ZONAVE/NDËRTIMEVE INFORMALE**

Pozicioni	Kategoria	Kriteri minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt të pranimit në pozicionin përkatës të punës	Shtesa për kushte pune
------------------	------------------	--	-------------------------------

		Paga e grupit	
Drejtor i drejtorive të ALUIZNI-t: Tiranë 1, Durrës, Lezhë, Vlorë 1, Shkodër	III-a/1	1	16.500
Drejtor i drejtorive të ALUIZNI-t: Tiranë 2 – Kamëz, Tiranë 2 – Paskuqan, Tiranë 2 – Farkë, Tiranë 2 – Vorë, Tiranë 3, Elbasan 1, Berat, Korçë, Fier 1, Kavajë, Vlorë 2, Elbasan 2, Fier 2, Sarandë, Lushnjë, Krujë, Pogradec, Gjirokastrë, Dibër, Kukës	III-b	1	16.500
Përgjegjës sektori	IV-a	1	10.000
Specialist	IV-b	1 ose 2 ose 3	10.000